REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 744/20
Datë/Datum. 02.11.20

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

DATË/A:	**02 NËNTOR 2020**
REFERENCË:	**744/20**
PËR/ZA/TO:	**AK- "ZPRK"**
NGA/OD/FROM:	**Blerim Dina - Kryetar i OSHP-së**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**NJOFTIM**

Operatori ekonomik **"Crazy Pet" Dr. Buba Njesia Nr.1 SHPK - Prishtinë**, si palë e pakënaqur me datën: 01.10.2020, ka parashtruar në OSHP ankesën me numër 744/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me paisje mbrojtëse Anti Covid-19"** me nr të prokurimit **102-20-4380-1-2-1**, duke pretenduar se AK ka shkelur këto dispozita ligjore:

- Neni 1, 6, 7, 27, 28, 52, 56.3, 59, 72 dhe 108 A të LPP-së.

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas pranimit të anekses, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 14 Tetor 2020 kanë autorizuar eksperten shqyrtuese të prokurimit për të shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit me datën 23.10.2020 ka dorëzuar raportin e ekspertizës dhe ka konstatuar që ankesa e OE ankues **Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të merret si pjesërisht e bazuar, dhe lënda të kthehet në rivlerësim**

Autoriteti kontraktues- **"ZPRK"** me datën 23Tetor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertes shqyrtuese të prokurimit dhe të njëjtit me datën 26 Tetor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **Jamë në pajtim me mendimin e Eksperit**.

Operatori ekonomik ankues **"Crazy Pet" Dr. Buba Njesia Nr.1 SHPK - Prishtinë** me datën 23 Tetor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertes shqyrtuese dhe të njëjtit me datën 26 Tetor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues njofton operatorin ekonomik ankues dhe autoritetin kontraktues se konform nenit 115 pika 3 i LPP-së që procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti kontraktues - **"ZPRK"** për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me paisje mbrojtëse Anti Covid-19"** me nr të prokurimit **102-20-4380-1-2-1** dhe njëkohësisht kanë konstatuar se e OE ankues te **të aprovohet, dhe se vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet, lënda të kthehet në Rivlerësim**, konform mendimit te dhënë ne raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta njoftojë me shkrim panelin shqyrtues lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik **"Crazy Pet" Dr. Buba Njesia Nr.1 SHPK - Prishtinë** konform nenit 118 pika 3 të LPP-së i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.